



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 954 Prot.

Tiranë, më 02.03.2022

Lënda: Kërkesë për mocion me debat në Kuvend

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA

KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

E nderuar zonja Kryetare,

Bazuar në Nenin 98, pika 1 e Rregullores së Kuvendit, ju paraqesim kërkesën për mocion me debat në Kuvend në lidhje me situatën në Ukrainë pas agresionit rus.

Në respekt të parimit të ruajtjes dhe mbrojtjes së integritetit territorial të një vendi mik të njohur ndërkombëtarisht si shtet i pavarur, si dhe në respekt të qindra mijëra civilëve të zhvendosur nga Ukraina për arësyte të pushtimit rus, në respekt të qindra civilëve ukrainas të vrarë gjatë pushtimit dhe agresionit rus mbi Ukrainën, propozojmë miratimin e një resolute, teksti i të cilës gjendet bashkangjitur kërkesës.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETËT:

Tjetren Xer
Albane Vokshi
Salmeva Sipahi Erpati
Bujar Lleskaj / Bujar
BELIND KËLLICI Belind Kelluci

Hermi Vokshi /
Lutfi Salaj /
Belind Kelluci /

Rezolutë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Paraqitur nga:

2 mars 2022

- Duke marrë parasysh vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Ukrainës në vitin 1922,
- Duke marrë parasysh njohjen e Ukrainës nga Organizata e Kombëve të Bashkuara në vitin 1945,
- Duke marrë parasysh dhe duke respektuar vullnetin e popullit të Ukrainës për pavarësi në vitin 1991,
- Duke respektuar dhe njohur pavarësinë e Ukrainës dhe integritetit të saj territorial në 24 gusht 1991,
- Duke marrë parasysh Rezolutën e Parlamentit European për Ukrainën më datë 1 mars 2022,
- Duke marrë parasysh rezolutat e mëparshme të Parlamentit European për Rusinë dhe Ukrainën,
- Duke marrë parasysh deklaratën e përfaqësuesit të lartë të Bashkimit European më 24 shkurt 2022,
- Duke marrë parasysh deklaratën e kryetarëve të shteteve dhe qeverive anëtare të NATO-s mbi sulmin e Rusisë në Ukrainë,
- Duke marrë parasysh seancën e jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi situatën në Ukrainë, të mbajtur më datë 28 shkurt 2022,
- Duke marrë parasysh deklaratat e Presidentit të Këshillit European dhe Presidentit të Komisionit European më datë 24 shkurt 2022 mbi pushtimin e Ukrainës nga forcat e armatosura të Federatës Ruse,
- Duke marrë parasysh deklaratën e vendeve të G7-tës më 24 shkurt 2022,
- Duke marrë parasysh memorandumin e Budapestit mbi garancitë e sigurisë të vitit 1994,
- Duke marrë parasysh Statutin e Romës së Gjykatës Ndërkombëtare Penale, të 17 korrikut 1998,
- Duke marrë parasysh Kartën e Kombeve të Bashkuara,
- Duke marrë parasysh Kartën e Helsinkit të vitit 1975,

- Duke marrë parasysh angazhimin e Republikës së Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s dhe anëtare jo-e përherëshme e Këshillit të Sigurimit,
- Duke marrë parasysh nënshkrimin e nismës për "Ballkanin e Hapur" dhe angazhimin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në këtë nismë në krah të Republikës së Serbisë e cila ende nuk njeh Pavarësinë e Republikës së Kosovës, dhe e konsideron Kosovën ende si pjesë përbërëse të saj në Preambulën e Kushtetutës së Serbisë,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

- a) dënon agresionin e Federatës Ruse mbi integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës,
- b) dënon agresionin e Federatës Ruse mbi popullsinë civile të shtetit të Ukrainës,
- c) dënon agresionin e Bjellorusisë mbi integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës dhe mbi popullsinë e shtetit të Ukrainës,
- d) dënon njohjen si shtete të pavarura të Donetsk dhe Luhansk dy qytete në Ukrainë, nga ana e Federatës Ruse,
- e) dënon përdorimin e armëve të rënda nga ana ushtrisë së Federatës Ruse, mbi popullsinë civile në Ukrainë,
- f) dënon kërcënimin për përdorimin e armëve bërthamore nga ana e Presidentit të Federatës Ruse,
- g) dënon agresionin e Federatës Ruse dhe ndërhyrjen Ruse në Ukrainë në vitin 2014,
- h) shpreh solidaritetin me popullin e Ukrainës që vuan pushtimin nga Federata Ruse,
- i) shpreh keqardhje dhe solidarizim me popullsinë civile të Ukrainës që po shpërngulet dhe zhvendoset nga vendi si pasojë e agresionit rus,
- j) dënon me forcë cdo akt dhune dhe sulmi ushtarak mbi popullsinë e Ukrainës nga ushtria e Federatës Ruse,
- k) shpreh mirënjojje për qëndrimin e Bashkimit European dhe NATO-s, organizatave ndërkombëtare financiare mbi vendosjen e sankioneve ekonomike, financiare dhe politike ndaj Federatës Ruse,
- l) shpreh mirënjojje për qëndrimin dhe ndihmën e aleatëve tanë strategjik Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Mbretërisë së Bashkuar në drejtim të popullit dhe të ushtrisë së Ukrainës për tu mbrojtur nga agresioni rus,

- m) shpreh mirënjohje për qëndrimin e vendeve mike të Shqipërisë si Zvicra, Suedia, Finlanda, Japonia dhe Australia, në mbështetje dhe në ndihmë të Ukrainës dhe popullit ukrainas për tu mbrojtur nga agresioni rus, si dhe për të ndaluar makinerinë ushtarake ruse në agresionin e saj në Ukrainë,
- n) dënon me forcë qëndrimin e Republikës së Serbisë për mos dënimin e agresionit Rus në Ukrainë;
- dhe i kërkon Qeverisë së Republikës së Shqipërisë,
- të marrë përsipër ndihmën e menjëherëshme për qeverinë dhe popullin e Ukrainës, në mbrojtje të integritetit të saj territorial të cënuar nga federata Ruse,
 - të ndihmojë në shpëtimin e jetëve të civilëve ukrainas të cilët kanë nevojë për rehabilitim nga pushtimi rus,
 - të largohet menjëherë nga nisma e "Balkanit të Hapur" e cila në përbërje të saj ka një shtet që nuk respekton cënimin e integritetit territorial të Ukrainës si dhe nuk dënon agresionin Rus mbi Ukrainën,
- ti japë fund nismës së Ballkanit të Hapur që bien në kundërshtim me interest kombëtar të Republikës së Shqipërisë dhe popullit shqiptar, si dhe bie ndesh me angazhimin e Shqipërisë për hapjen e negociatave me Bashkimin European dhe procesin e Berllinit ;
- të dënojë zyrtarisht dhe publikisht qëndrimin e Republikës së Serbisë ndaj cënimit të integritetit territorial të një vendi mik dhe pushtimin e tij nga një vend fqinj që në këtë rast është Federata Ruse,
 - të marrë masat për të parandaluar cdo përpjekje të Serbisë dhe Rúsise për të destabilizuar Ballkanin Perëndimor,

Në respekt të parimit të ruatjes dhe mbrojtjes së integritetit territorial të një vendi mik të njojur ndërkombëtarisht si shtet i pavarur, si dhe në respekt të qindra mijëra civilëve të zhvendosur nga Ukraina për arsyen e pushtimit rus;; në respekt të qindra civilëve ukrainas të vrarë gjatë pushtimit dhe agresionit rus mbi Ukrainën,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendos sot këtë rezolutë për Ukrainën, më datë 2 mars 2022.